Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

**DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT
PRISHTINË**

# R A P O R T

## SUKSESI I NXËNËSVE NË FUNDVITIN SHKOLLOR 2014/15

***Prishtinë  20.09.2015***

**Përmbajtja:**

Hyrje....3

***Suksesi në nivelin e arsimit fillor (I-V)***....4

*Suksesi i nxënësve të arritur për secilën lëndë*....5

*Realizimi i orëve të planifikuar për nivelin e parë të arsimit*....6

*Vijueshmëria e nxënësve*....6

***Suksesi në nivelin e arsimit të mesëm të ulët (VI-IX)***....7

*Suksesi i nxënësve të arritur për secilën lëndë*....7

*Rezultatet e Testit të Arritshmërisë*....8

*Realizimi i orëve të planifikuar për nivelin e dytë të arsimit*....10

*Vijueshmëria e nxënësve*....11

***Suksesi në nivelin e arsimit të mesëm të lartë (X-XII)***....11

*Rezultatet e nxënësve të nivelit të mesëm të lartë, të arritur në lëndët e përgjithshme*....12

*Rezultatet e provimit shtetëror të maturës*....14

*Realizimi i orëve të planifikuar për nivelin e tretë të arsimit*....18

*Vijueshmëria e nxënësve*....18

*Tabelat e suksesit për të tri nivelet e arsimit parauniversitar*....19

*Konkluzioni*....27

*Rekomandimet*....29



Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

## Hyrje

Drejtoria e Arsimit e Prishtinës, në çdo fundvit shkollor bënë një vlerësim të përgjithshëm për ecurinë dhe performancën e procesit mësimor dhe analizon suksesin e nxënësve për rezultatet e arritura, për të tri nivelet e arsimit parauniversitar, duke krahasuar rezultatet e suksesit me rezultatet e periudhës së njëjtë të vitit paraprak.

Po ashtu, këtë vit shkollor janë vlerësuar dhe analizuar rezultatet e testeve të jashtme: Testit të Arritshmërisë dhe Provimit Shtetëror të Maturës, duke i krahasuar me rezultatet e vlerësimit të brendshëm. Duke ditur se vlerësimi është një proces dhe indikator determinues për nxjerrjen e treguesve kryesor, për ngritjen e cilësisë në arsim dhe për krijimin e një sistemit arsimor bashkëkohor në përputhje me kërkesat e shoqërisë së sotme - shoqërisë së dijes, kjo analizë bëhet jo vetëm për të konstatuar gjendjen, por edhe për të përcaktuar objektivat për të ardhmen, që do të reflektojnë pozitivisht në përmirësimin e shkallës së arritshmërisë së nxënësve dhe ngritjen e cilësisë së mësimdhënies në procesin edukativo-arsimor.

Drejtoria Komunale e Arsimit po punon në mënyrë të vazhdueshme, për krijimin e kushteve më të mira me qëllim që cilësia dhe rezultatet e suksesit në shkollat tona të shënojë progres dhe të arrijnë në nivelin e shkollave të përparuara, si: në mësimdhënie, në mësimnxënie dhe të një vlerësimi sa më objektiv të arritshmërisë së nxënësve.



Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

## SUKSESI NË NIVELIN E ARSIMIT FILLOR-(I-V)

Në Komunën e Prishtinës janë gjithsej **43** shkolla fillore dhe të mesme të ulëta amë me **18** paralele të ndara fizike. Në këto shkolla mësimin, në vitin shkollor **2014/15,** e kanë vijuar **31.359** nxënës, të shpërndarë në **1.306** paralele, që i bie mesatarisht **24,01** nxënës për paralele.
Nëse shohim vijueshmërinë sipas klasave kemi këtë pasqyrë:
- Në nivelin e arsimit fillor, **I-V**, kanë vijuar **16.947** nxënës, të shpërndarë në **732** paralele, mesatarisht **23,15** nxënës për paralele, ndërsa në nivelin e arsimit të mesëm të ulët, **VI-IX,** gjithsej **14.412** nxënës, të shpërndarë në **574** paralele, mesatarisht **25,10** nxënës për paralele. Në këtë numër të përgjithshëm të nxënësve nuk janë përfshirë **2.257** nxënës të nivelit parafillor.

Vlenë të theksohet se mesatarja e numrit të nxënësve për paralele **23,15** të nivelit fillor dhe **25,10** të mesëm të ulët, është pasojë e numrit jashtëzakonisht të vogël të nxënësve në shkollat e vendbanimeve rurale të Komunës së Prishtinës, në të cilat shkolla kemi hapësirë të madhe shkollore në krahasim me numrin e nxënësve. E kundërt është gjendja në shkollat e qytetit, ku kemi numër të madh të nxënësve dhe hapësirë jo të mjaftueshme shkollore.

-Suksesi i arritur i nxënësve në nivelin fillor të arsimit, është si më poshtë: **16722** nxënës me sukses pozitiv **apo** **98.67**-përqind, **47** me sukses të pamjaftueshëm, **0.27-** përqind dhe **178** nxënës të panotuar**,** **1.05**-përqind, Suksesi sipas vlerësimit të përgjithshëm përfundimtar është:

- ⇒ **me sukses të shkëlqyeshëm 12962 nxënës, ose 76.50-përqind**
- ⇒ **me sukses shumë të mirë 2360 nxënës, ose 13,93-përqind**
- ⇒ **me sukses të mirë 1111 nxënës, ose 6,56-përqind**
- ⇒ **me sukses të mjaftueshëm 289 nxënës, ose 1,71-përqind**
- ⇒ **me sukses pamjaftueshem gjithsej 47 nxënës, ose 0,28-përqind**
- ⇒ **të panotuar 178 nxënës, ose 1,03-përqind**




**Graf. 1. Pasqyron suksesin e nxënësve të nivelit fillor (I-V).**



Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

Është indikativ fakti se, vlerësimi si proces vazhdon të jetë sfidues për sistemin e arsimit në Kosovë, ku në bazë të statistikave të dhëna konsiderojmë, se në këtë nivel të arsimit fillor (I-V), nuk ka standard të qartë dhe unik sa i përket vlerësimit, e për këtë dëshmon edhe nota mesatare **4.48.** Nëse suksesin e arritur e krahasojmë me rezultate të vlerësimeve të jashtme ka dallime të dukshme.

## Suksesi i arritur për secilën lëndë

Drejtoria e Arsimit në fund të vitit shkollor 2014/15, ka realizuar një analizë të përgjithshme suksesit dhe rezultateve të nxënësve të arritura në secilën lëndë.

| Nr | Lënda | Nr. nxënësve | | | Suksesi pozitiv | | | | | | | | | | Suksesi i pamjaftueshëm | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Shkëlqyeshëm | | Sh. mirë | | Mirë | | Mjaftueshëm | | Gjithsej me nota pozitive | | Me notë të pamjaftueshme | | Të pa notuar | | Nota mesatare |
| | | M | F | GJ | Nr | % | Nr | % | Nr | % | Nr | % | Nr | % | Nr | % | Nr | % | |
| 1 | Gjuhë shqipe | 8468 | 8040 | 16508 | 11601 | 70.28 | 2536 | 15.36 | 1476 | 8.94 | 679 | 4.11 | 16292 | 98.69 | 41 | 0.25 | 175 | 1.06 | 4.16 |
| 2 | Gjuhë angleze | 5519 | 5154 | 10673 | 6897 | 64.62 | 1561 | 14.63 | 1266 | 11.86 | 828 | 7.76 | 10552 | 98.87 | 18 | 0.17 | 103 | 0.97 | 4.12 |
| 3 | Histori | 2037 | 1884 | 3921 | 2557 | 65.21 | 704 | 17.95 | 370 | 9.44 | 255 | 6.50 | 3886 | 99.11 | 0 | 0.00 | 35 | 0.89 | 4.10 |
| 4 | Edukatë qytetare | 5380 | 4991 | 10371 | 6946 | 66.98 | 1510 | 14.56 | 1216 | 11.73 | 575 | 5.54 | 10247 | 98.80 | 19 | 0.18 | 105 | 1.01 | 4.17 |
| 5 | Edukatë fizike dhe sportive | 8486 | 8059 | 16545 | 15151 | 91.57 | 810 | 4.90 | 325 | 1.96 | 80 | 0.48 | 16366 | 98.92 | 2 | 0.01 | 177 | 1.07 | 4.69 |
| 6 | Matematikë | 8486 | 8059 | 16545 | 11208 | 67.74 | 2523 | 15.25 | 1655 | 10.00 | 939 | 5.68 | 16325 | 98.67 | 44 | 0.27 | 176 | 1.06 | 4.21 |
| 7 | Edukatë figurativ | 8486 | 8059 | 16545 | 13964 | 84.40 | 1462 | 8.84 | 738 | 4.46 | 200 | 1.21 | 16364 | 98.91 | 4 | 0.02 | 177 | 1.07 | 4.57 |
| 8 | Punëdore | 8327 | 7881 | 16208 | 13248 | 81.74 | 1588 | 9.80 | 888 | 5.48 | 302 | 1.86 | 16077 | 99.19 | 5 | 0.03 | 177 | 1.09 | 4.51 |
| 9 | Njeriu dhe natyra | 5656 | 5309 | 10965 | 7279 | 66.38 | 1672 | 15.25 | 1198 | 10.93 | 694 | 6.33 | 10843 | 98.89 | 18 | 0.16 | 104 | 0.95 | 4.16 |
| 10 | Edukatë muzikore | 8486 | 8059 | 16545 | 14013 | 84.70 | 1387 | 8.38 | 743 | 4.49 | 221 | 1.34 | 16364 | 98.91 | 4 | 0.02 | 177 | 1.07 | 4.61 |

| Nr. | Lënda | N.M |
|---|---|---|
| 1 | Gjuhë shqipe | 4.16 |
| 2 | Gjuhë angleze | 4.12 |
| 3 | Histori | 4.10 |
| 4 | Edukatë qytetare | 4.17 |
| 5 | Edukatë fizike dhe sportive | 4.69 |
| 6 | Matematikë | 4.21 |
| 7 | Edukatë figurativ | 4.57 |
| 8 | Punëdore | 4.51 |
| 9 | Njeriu dhe natyra | 4.16 |
| 10 | Edukatë muzikore | 4.61 |




**Graf. 2. Paraqitja e suksesit të nxënësve në nivelit fillor, të arritur për secilën lëndë.**



Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

**Realizimi i orëve të planifikuara për vitin shkollor 2014/15:**
Orët e planifkuara për nivelin e parë të arsimit, për vitin shkollor 2014/15:
-gjithsej **637804 orë,**
-të realizuara **633762 orë,**
-të parealizuara **4042 orë**
Gjithsej të realizuara **99.36**-përqind, ndërsa mesatarja e orëve të realizuara në vitin 2014/15 ishte **99.50**-përqind.



**Graf. 3. Paraqitja e realizimit të orëve të planifikuara, të realizuara dhe të pambajtura.**

**Vijueshmëria e nxënësve:**

-Gjatë vitit shkollor 2014/15, në nivelin e arsimit fillor janë regjistruar gjithësej **286869 ose 16.92** mungesa për nxënës, prej tyre:
- të arsyeshme **264351 ose 15.58** mungesa për nxënës , të paarsyeshme **22518 ose 1.326** mungesa për nxënës.

Numri i nxënësve për këtë nivel të arsimit gjatë vitit shkollor 2014/15:
-**16947** nxënës, prej tyre **M 8600**, ose **50.74**-përqind dhe **F 8347**, ose **49.25-**përqind.



**Graf. 4. Paraqitja e mungesave të nivelit (I-V).**



Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

## SUKSESI NË NIVELIN E ARSIMIT TË MESËM I ULËT- (VI-IX)

Numri i përgjithshëm i nxënësve në nivelin e mesëm të ulët, **VI – IX** është **14412** nxënës, të shpërndarë në **574** paralele, mesatarisht **25.10** nxënës për paralele. Prej tyre **14241** nxënës kanë përfunduar me sukses pozitiv ose **98.23**-përqind, ndërsa **66** nxënës me sukses të pamjaftueshëm ose **0.45**-përqind, dhe **105** nxënës të pabotuar ose **0.73**-përqind, gjegjësisht:

- ⇒ **me sukses të shkëlqyeshëm 5858 nxënës ose 40.65-përqind,**
- ⇒ **me sukses shumë të mirë 3155 nxënës ose 21.89-përqind,**
- ⇒ **me sukses të mirë 2420 nxënës ose 23.73-përqind,**
- ⇒ **me sukses të mjaftueshëm 1808 nxënës ose 12.55-përqind,**
- ⇒ **me sukses të pamjaftueshëm 66 nxënës ose 0.46-përqind, dhe**
- ⇒ **të panotuar 105 nxënës ose 0.73-përqind.**




**Graf. 5. Pasqyron suksesin e nxënësve të nivelit të mesëm të ulët (VI-IX).**

Ajo që bie në sy është fakti se në këtë nivel të arsimit ka një dallim të dukshëm në vlerësim, në raport me vlerësimin e nivelit fillor. Por, nëse krahasohet me rezultatet e vlerësimit të jashtëm shihet se ka më shumë afërsi me notën mesatare **3.86.** Krahasuar me suksesin e vitit paraprak, për këtë nivel të arsimit suksesi ka shënuar një rënie të lehtë për **0.02 -përqind.**

## Suksesi i arritur për secilën lëndë

Drejtoria e Arsimit edhe për këtë nivel të arsimit në fund të vitit shkollor **2014/15**, ka realizuar një analizë të përgjithshme të suksesit dhe rezultateve të nxënësve të arritur për secilën lëndë, duke krahasuar me rezultatet e vlerësimit të jashtëm. Nga kjo analizë konstatohet se nga vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm ka disproporcion të madh në standardin e vlerësimit.



Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

Në vijim paraqesim rezultatet:

| Nr | Lënda | Nr. nxënësve | | | Suksesi pozitiv | | | | | | | | | | Suksesi i pamjaftueshëm | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Shkëlqyeshëm | | Sh. mirë | | Mirë | | Mjaftueshëm | | Gjithsej me nota pozitive | | Me notë të pamjaftueshme | | Të pa notuar | | Nota mesatare |
| | | | | | Nr | % | Nr | % | Nr | % | Nr | % | Nr | % | Nr | % | Nr | % | |
| | | M | F | GJ | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | Gjuhë shqipe | 7456 | 6856 | 14312 | 5878 | 41.07 | 2308 | 16.13 | 2869 | 20.05 | 3074 | 21.48 | 14156 | 98.91 | 77 | 0.54 | 106 | 0.74 | 3.68 |
| 2 | Gjuhë angleze | 7456 | 6856 | 14312 | 6582 | 45.99 | 2129 | 14.88 | 2318 | 16.20 | 3109 | 21.72 | 14155 | 98.90 | 67 | 0.47 | 107 | 0.75 | 3.66 |
| 3 | Gjuhë gjermane | 195 | 180 | 375 | 219 | 58.40 | 73 | 19.47 | 42 | 11.20 | 41 | 10.93 | 375 | 100.00 | | | | | 4.24 |
| 4 | Gjuhë frenge | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 5 | Histori | 7456 | 6856 | 14312 | 6036 | 42.17 | 2094 | 14.63 | 2509 | 17.53 | 3424 | 23.92 | 14063 | 98.26 | 142 | 0.99 | 107 | 0.75 | 3.64 |
| 6 | **Edukatë qytetare** | **7456** | **6856** | **14312** | **6973** | **48.72** | **2089** | **14.60** | **2472** | **17.27** | **2651** | **18.52** | **14185** | **99.11** | **20** | **0.14** | **107** | **0.75** | **3.8** |
| 7 | **Biologji** | **7456** | **6856** | **14312** | **5819** | **40.66** | **2166** | **15.13** | **2721** | **19.01** | **3444** | **24.06** | **14150** | **98.87** | **55** | **0.38** | **107** | **0.75** | **3.56** |
| 8 | **Fizikë** | **7456** | **6856** | **14312** | **4900** | **34.24** | **2129** | **14.88** | **2843** | **19.86** | **4188** | **29.26** | **14060** | **98.24** | **145** | **1.01** | **107** | **0.75** | **3.42** |
| 9 | **Edukatë fizike dhe sportiv** | **7456** | **6856** | **14312** | **10363** | **72.41** | **2217** | **15.49** | **1223** | **8.55** | **400** | **2.79** | **14203** | **99.24** | **2** | **0.01** | **107** | **0.75** | **4.4** |
| 10 | **Teknologji** | **7456** | **6856** | **14312** | **7287** | **50.92** | **2321** | **16.22** | **2424** | **16.94** | **2155** | **15.06** | **13688** | **95.64** | **18** | **0.13** | **107** | **0.75** | **3.92** |
| 11 | **Matematikë** | **7456** | **6856** | **14312** | **4522** | **31.60** | **2054** | **14.35** | **2762** | **19.30** | **4704** | **32.87** | **14042** | **98.11** | **164** | **1.15** | **106** | **0.74** | **3.28** |
| 12 | **Gjeografi** | **7456** | **6856** | **14312** | **5854** | **40.90** | **2187** | **15.28** | **2549** | **17.81** | **3562** | **24.89** | **14152** | **98.88** | **53** | **0.37** | **107** | **0.75** | **3.59** |
| 13 | **Art figurativ** | **7456** | **6856** | **14312** | **8602** | **60.10** | **2202** | **15.39** | **1933** | **13.51** | **1459** | **10.19** | **13698** | **95.71** | **7** | **0.05** | **109** | **0.76** | **4.18** |
| 14 | **Kimi** | **5839** | **5406** | **11245** | **4042** | **35.94** | **1650** | **14.67** | **2216** | **19.71** | **3177** | **28.25** | **11085** | **98.58** | **84** | **0.75** | **76** | **0.68** | **3.42** |
| 15 | **Edukatë muzikore** | **7453** | **6856** | **14309** | **7553** | **52.78** | **2237** | **15.63** | **2316** | **16.19** | **2084** | **14.56** | **14190** | **99.17** | **12** | **0.08** | **107** | **0.75** | **4.01** |

| Nr. | Lënda | NM |
|---|---|---|
| 1 | Gjuhë shqipe | 3.68 |
| 2 | Gjuhë angleze | 3.66 |
| 3 | Gjuhë gjermane | 4.24 |
| 4 | Gjuhë frenge | |
| 5 | Histori | 3.64 |
| 6 | **Edukatë qytetare** | **3.8** |
| 7 | **Biologji** | **3.56** |
| 8 | **Fizikë** | **3.42** |
| 9 | **Edukatë fizike dhe sportiv** | **4.4** |
| 10 | **Teknologji** | **3.92** |
| 11 | **Matematikë** | **3.28** |
| 12 | **Gjeografi** | **3.59** |
| 13 | **Art figurativ** | **4.18** |
| 14 | **Kimi** | **3.42** |
| 15 | **Edukatë muzikore** | **4.01** |




**Graf. 6. Paraqitja e suksesit për secilën lëndë, të nxënësve në nivelit e mesëm të ulët (VI-IX).**

## REZULTATET E TESTIT TË ARRITSHMËRISË 2014-15

Në lidhje me testin e arritshmërisë që në fillim vlen të ceket se, Drejtoria e Arsimit pas analizës së përgjithshme të rezultateve, formës së organizimit dhe ecurisë së Testit të Arritshmërisë në raport me vitet paraprake, këtë vit ka marrë gjitha masat e nevojshme për një proces të drejtë:

1. Ka bërë ndryshime në formën dhe organizimin e testit, duke e shtuar numrin e qendrave nga tetë (8) në njëmbëdhjetë (11), për të krijuar kushte dhe



Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

standarde të mira për punë, gjë që ka reflektuar pozitivisht në mbarëvajtjen e testit dhe rezultate më të mira dhe reale;

2. Për një proces të mirëfilltë të testimit dhe vlerësimit të standardizuar, këtë vit ka ndryshuar formën e organizimit të Testit Arritshmërisë, një nxënës një bankë dhe kjo formë ka reflektuar pozitivisht në ecurinë dhe cilësinë e këtij procesi;
3. Janë organizuar takime pune me drejtuesit e institucioneve edukativo-arsimore dhe mësimdhënësit të cilët e kanë administruar dhe monitoruar procesin e Testit të Arritshmërisë;
4. Për një proces të drejtë, Drejtoria e Arsimit ka nxjerrë vendim për detyrat dhe përgjegjësitë e administruesve;
5. Po ashtu në këtë vit, Drejtoria e Arsimit ka realizuar një analizë, vlerësim të suksesit të arritur për të tri nivelet e arsimit para universitar, duke krahasuar dhe analizuar rezultatet e vlerësimit të brendshëm me rezultatet e vlerësimit të jashtëm duke e ditur se procesi i vlerësimit është një ndër çështjet më të ndjeshme dhe sfiduese për sistemin e arsimit në Republikën e Kosovës.

Rezultatet e Testit të Arritshmëria në nivel komune janë **60.7-përqind.** Ne konsiderojmë se këto rezultate nuk janë të kënaqshme dhe shqetësuese mbeten dallimet e mëdha në mes vlerësimit të brendshëm dhe atij të jashtëm. Kjo lë dilema për një vlerësim real dhe të standardizuar çoftë ky i brendshëm apo i jashtëm. Sa i përket vlerësimit të brendshëm ka dallime të mëdha edhe në mes të vet mësimdhënësve. Kurse në raport me vlerësimin e jashtëm forma e organizimit të Testit të Arritshmërisë kur brenda tri orësh nxënësit duhet t'i nënshtrohen testit në nëntë lëndë mësimore, kur kihet parasysh se kjo ndikon në masë të madhe edhe në vijimin e shkollimit të nxënësve, presioni është mjaft i madh për moshën e fëmijëve dhe kjo mund të ndikoj mjaft.




**Graf. 7. Pasqyron rezultatet e testit të arritshmërisë për secilën lëndë.**



Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

**Krahasueshmëria në mes vlerësimit të brendshëm me vlerësimin e jashtëm:**




**Graf. 8. Pasqyron krahasueshmërinë e vlerësimit të brendshëm me atë të jashtëm.**

## Realizimi i orëve të planifikuara për vitin shkollor 2014/15:

Orët e planifkuara për nivelin e dytë të arsimit, për vitin shkollor 2014/15:

-gjithsej **673768** –orë,

-të realizuara **664213**-orë,

-të parealizuara **9555**-orë

Në përqindje për këtë vit shkollor, kemi **98.58** – përqind realizimin e orëve të planifikuara, që krahasuar me vitin paraprak kemi një ulje në realizimin e orëve të planifikuara për **0.29** – përqind.




**Graf. 9. Paraqitja e realizimit të orëve të planifikuara, të realizuara dhe të pambajtura.**



Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

## Vijueshmëria e nxënësve:

Në nivelin e arsimit të mesën të ulët, gjatë vitit shkollor 2014/15, janë regjistruar gjithsej **415985** **ose** **28.87** mungesa për nxënës, prej tyre të arsyeshme: **319246** **ose** **22.15** mungesa për nxënës, të paarsyeshme **96592**, **6.70** mungesa për nxënës.
Numri i nxënësve për këtë nivel të arsimit gjatë vitit shkollor 2014/15:
-**14412** nxënës, prej tyre **M-7464**, ose **51.79**-përqind dhe **F-6948**, ose **48.20**-përqind.




**Graf. 10. Paraqitja e mungesave të nivelit (VI-IX).**

## SUKSESI NË NIVELIN E ARSIMIT TË MESËM TË LARTË-(X-XII)

Në nivelin e arsimit të mesëm të lartë gjithsej **13** shkolla, ku mësimin e kanë vijuar **10313** nxënës, të shpërndarë në **345** paralele, mesatarisht **29.89** nxënës për paralele. Theksojmë se mesatarja e numrit të nxënësve për paralele, **29.89** për këtë nivel të arsimit është pasojë e numrit të vogël të nxënësve në shkollat profesionale në krahasim me gjimnazet, ku kemi të bëjmë me një sterngarkim të paraleleve. Por, regjistrimi i nxënësve në dy vitet e fundit ka shënuar kthesë pozitive, ku kemi vijueshmëri të mirë edhe në shkollat profesionale.
Kalueshmëria e nxënësve, në këtë nivel të arsimit është: **9963** nxënës me sukses pozitiv apo **96.60**-përqind, ndërsa **170** nxënës me sukses të pamjaftueshëm apo **1.64**-përqind, dhe **180** të panotuar, apo **1.75**-përqind, prej tyre:

- ⇒ **me sukses të shkëlqyeshëm 2821 nxënës ose 27.35-përqind**
- ⇒ **me sukses shumë të mirë 2471 nxënës ose 23.96-përqind**
- ⇒ **me sukses të mirë 2938 nxënës ose 28.49-përqind**
- ⇒ **me sukses të mjaftueshëm 1733 nxënës ose 16.80-përqind**
- ⇒ **me sukses të pamjaftueshëm 170, nxënës ose 1.65-përqind**
- ⇒ **të panotuar 180 nxënës ose 1.75-përqind:**



Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org




**Graf. 11. Pasqyron suksesin e nxënësve të nivelit të mesëm të lartë (X-XII).**

Nota mesatare e nxënësve të këtij niveli të arsimit është **3.54**, që krahasuar me notën mesatare e vitit të kaluar ka shënuar një ngritje të lehtë për **0.11**.

Në këtë nivel të arsimit kërkohet nga drejtuesit dhe mësimdhënësit e shkollës një angazhim më i madh, që cilësia e arsimit në këtë nivel të përmirësohet.

## Suksesi i arritur në lëndët e përgjithshme

Gjithashtu, edhe në nivelin e arsimit të mesëm të lartë kemi analizuar suksesin e arritur të nxënësve, për lëndët e përgjithshme.



Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

| Nr | Lënda | Nr. nxënësve | | | Suksesi pozitiv | | | | | | | | | | Suksesi i pamjaftueshëm | | | | Nota mesatare |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Shkëlqyeshëm | | Sh. mirë | | Mirë | | Mjaftueshëm | | Gjithsej me nota pozitive | | Me notë të pamjaftueshme | | Të pa notuar | | |
| | | | | | Nr | % | Nr | % | Nr | % | Nr | % | Nr | % | Nr | % | Nr | % | |
| | | M | F | GJ | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | Gjuhë shqipe | 4862 | 5225 | 10087 | 3184 | 31.57 | 1440 | 14.28 | 2052 | 20.34 | 3129 | 31.02 | 9805 | 97.20 | 94 | 93.2% | 188 | 1.9 | **3.38** |
| 2 | Gjuhë angleze | 4868 | 5219 | 10087 | 3308 | 32.79 | 1746 | 17.31 | 1985 | 19.68 | 2756 | 27.32 | 9795 | 97.10 | 102 | 101.1% | 190 | 1.9 | **3.50** |
| 3 | Gjuhë gjermane | 1644 | 2497 | 4141 | 1428 | 34.48 | 862 | 20.82 | 1021 | 24.66 | 763 | 18.43 | 4074 | 98.38 | 13 | 31.4% | 54 | 1.3 | **3.70** |
| 4 | Gjuhë frenge | 1018 | 1283 | 2301 | 859 | 37.33 | 505 | 21.95 | 442 | 19.21 | 420 | 18.25 | 2226 | 96.74 | 1 | 4.3% | 74 | 3.2 | **3.61** |
| 5 | Gjuhë latine | 296 | 432 | 728 | 324 | 44.51 | 103 | 14.15 | 90 | 12.36 | 190 | 26.10 | 707 | 97.12 | 6 | 82.4% | 15 | 4.2 | **3.69** |
| 6 | Histori | 2091 | 2552 | 4643 | 2053 | 44.22 | 815 | 17.55 | 772 | 16.63 | 865 | 18.63 | 4505 | 97.03 | 46 | 99.1% | 92 | 2 | **3.36** |
| 7 | Edukatë qytetare | 1687 | 1503 | 3190 | 1190 | 37.30 | 467 | 14.64 | 578 | 18.12 | 861 | 26.99 | 3096 | 97.05 | 32 | 1.0031 | 62 | 1.9 | **3.38** |
| 8 | Biologji | 2356 | 3085 | 5441 | 2173 | 39.94 | 841 | 15.46 | 1082 | 19.89 | 1230 | 22.61 | 5326 | 97.89 | 31 | 0.5697 | 84 | 1.5 | **3.51** |
| 9 | Fizikë | 3420 | 3611 | 7031 | 1742 | 24.78 | 1019 | 14.49 | 1512 | 21.50 | 2594 | 36.89 | 6867 | 97.67 | 82 | 1.1663 | 82 | 1.2 | **3.1** |
| 10 | Edukatë fizike dhe sportive | 4868 | 5219 | 10087 | 6297 | 62.43 | 1975 | 19.58 | 1124 | 11.14 | 478 | 4.74 | 9874 | 97.89 | 24 | 0.2379 | 189 | 1.9 | **4.41** |
| 11 | Teknologji | 4838 | 5185 | 10023 | 3487 | 34.79 | 1621 | 16.17 | 2000 | 19.95 | 2680 | 26.74 | 9788 | 97.66 | 59 | 0.5886 | 176 | 1.8 | **3.6** |
| 12 | Matematikë | 4409 | 4492 | 8901 | 1663 | 18.68 | 1113 | 12.50 | 1782 | 20.02 | 4041 | 45.40 | 8599 | 96.61 | 129 | 1.4493 | 173 | 1.9 | **2.9** |
| 13 | Gjeografi | 2979 | 3321 | 6300 | 1917 | 30.43 | 1079 | 17.13 | 1288 | 20.44 | 1876 | 29.78 | 6160 | 97.78 | 25 | 0.3968 | 115 | 1.8 | **3.4** |
| 14 | Art figurativ | 1103 | 1455 | 2558 | 1060 | 41.44 | 450 | 17.59 | 541 | 21.15 | 464 | 18.14 | 2515 | 128.30 | 13 | 0.5082 | 30 | 1.2 | **3.71** |
| 15 | Kimi | 3081 | 3509 | 6590 | 1954 | 29.65 | 933 | 14.16 | 1398 | 21.21 | 2153 | 32.67 | 6438 | 97.69 | 60 | 0.9105 | 92 | 1.4 | **3.27** |
| 16 | Sociologji | 741 | 967 | 1708 | 517 | 30.27 | 267 | 15.63 | 380 | 22.25 | 533 | 31.21 | 1697 | 99.36 | 0 | 0 | 11 | 0.6 | **3.53** |
| 17 | Filozofi | 529 | 758 | 1287 | 577 | 44.83 | 224 | 17.40 | 196 | 15.23 | 279 | 21.68 | 1276 | 99.15 | 0 | 0 | 11 | 0.9 | **3.71** |
| 18 | Logjikë | 457 | 681 | 1138 | 364 | 31.99 | 161 | 14.15 | 254 | 22.32 | 341 | 29.96 | 1120 | 98.42 | 6 | 0.5272 | 12 | 1.1 | **3.42** |
| 19 | Astronomi | 363 | 452 | 815 | 449 | 55.09 | 98 | 12.02 | 122 | 14.97 | 143 | 17.55 | 812 | 99.63 | 0 | 0 | 3 | 0.4 | **4.08** |
| 20 | Psikologji | 1661 | 1942 | 3602 | 1499 | 41.62 | 500 | 13.88 | 598 | 16.60 | 935 | 25.96 | 3532 | 98.06 | 4 | 0.111 | 66 | 1.8 | **3.5** |
| 21 | Ekonomi | 2110 | 1600 | 3710 | 815 | 21.97 | 417 | 11.24 | 669 | 18.03 | 1652 | 44.53 | 3553 | 95.77 | 46 | 1.2399 | 111 | 3 | **3** |
| 22 | Edukatë muzikore | 1248 | 1769 | 3017 | 1733 | 57.44 | 555 | 18.40 | 423 | 14.02 | 272 | 9.02 | 2983 | 98.87 | 13 | 0.4309 | 21 | 0.7 | **4.04** |

| Nr. | Lënda | N.M |
|---|---|---|
| 1 | Gjuhë shqipe | 3.38 |
| 2 | Gjuhë angleze | 3.50 |
| 3 | Gjuhë gjermane | 3.70 |
| 4 | Gjuhë frenge | 3.61 |
| 5 | Gjuhë latine | 3.69 |
| 6 | Histori | 3.36 |
| 7 | Edukatë qytetare | 3.38 |
| 8 | Biologji | 3.51 |
| 9 | Fizikë | 3.1 |
| 10 | Edukatë fizike dhe sportive | 4.41 |
| 11 | Teknologji | 3.6 |
| 12 | Matematikë | 2.9 |
| 13 | Gjeografi | 3.4 |
| 14 | Art figurativ | 3.71 |
| 15 | Kimi | 3.27 |
| 16 | Sociologji | 3.53 |
| 17 | Filozofi | 3.71 |
| 18 | Logjikë | 3.42 |
| 19 | Astronomi | 4.08 |
| 20 | Psikologji | 3.5 |
| 21 | Ekonomi | 3 |
| 22 | Edukatë muzikore | 4.04 |




**Graf. 12. Paraqitja e suksesit për lëndët e përgjithshme, të nxënësve në nivelit e mesëm të lartë (X-XII).**



Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

## REZULTATET PROVIMI SHTETËROR I MATURËS

Në vitin shkollor 2014/15, nga puna jonë në shkolla mund të konstatojmë se organizimi, menaxhimi dhe mbarëvajtja e provimit të maturës shtetërore ishte në nivel më të kënaqshëm, në krahasim me vitet paraprake. Por, sipas nesh akoma sfiduese mbeten: përgatitja e testeve sipas profileve dhe planprogrameve që zhvillojnë shkollat e ndryshme, modeli me shumë lëndë mësimore, shumë kërkesa për testin njëditor dhe tendenca e vazhdueshme e nxënësve, e në disa raste edhe e administruesve për të kopjuar apo për të lejuar dhe mbështetur kopjimin.

Do të theksonim se pjesa e parë e testit të maturës përpilohet i njëjtë si për gjimnaze ashtu edhe për shkolla profesionale, gjë që sipas nesh nuk është në rregull kur dihet se gjimnazet p.sh. në lëndën e matematikës kanë katër **(4)** e më shumë orë mësim në javë, ndërsa shkollat profesionale dy **(2)** orë në javë.

Në afatin e parë me 6 qershor dhe 20 qershor, në Komunën e Prishtinës iu nënshtruan provimit **3582** maturantë, ku sukses pozitiv kanë arritur **2403** nxënës, apo **67.09** – përqind.

Ndërsa, në afatin e dytë, më **29** gusht dhe me **5** shtator, provimit iu kanë nënshtruar **1464** maturantë, prej tyre sukses pozitiv kanë arritur **802** nxënës, apo **54.78**-përqind.

Në këtë vit shkollor, provimin e maturës shtetërore në Komunën e Prishtinës e kanë kaluar **3025** nxënës apo **82.88** –përqind. Krahasuar me suksesin e vitit paraprak, është shënuar një rënie të lehtë në rezultate prej **6.1**-përqind.

Kjo rënie e kalueshmërisë prej 6.1-përqind, ka reflektuar mbase ngase Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, për këtë gjeneratë nuk e ka ulur pragun e kalueshmërisë siç ka vepruar në vitet paraprake.




**Graf. 13. Paraqitja e rezultateve të Testit të Maturës.**

Për të përmirësuar cilësinë e të nxënit të nxënësit, metodologjinë e mësimdhënies dhe përgjithësisht punën në shkollë, praktikohet realizimi i vlerësimit të brendshëm dhe vlerësimit të jashtëm.



Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

Në këtë vit është realizuar një analizë e përgjithshme e rezultatit të provimit të maturës për secilën lëndë, duke e krahasuar me rezultatet e brendshme të vlerësimit. Duke e ditur se vlerësimi i brendshëm ende nuk është monitoruar në nivel kombëtar dhe nuk ka një analizë reale për dallimet në mes ndryshimit në vlerësimin e brendshëm dhe atij të jashtëm. Kjo situatë vie në pah në mënyrë shumë të dukshme në dallimet nga një shkollë në tjetrën dhe sidomos kur nxënësit e shkollave të ndryshme çoftë nga shkollat e zonave rurale apo brenda vetë qytetit nuk arrijnë të kenë rezultate të njëjta apo të përafërta kur kalojnë nga një shkollë në shkollën tjetër, për shkak të moszbatimit e kritereve të standardizuara të vlerësimit të brendshëm. Pra, është evident fakti se ka mungesë të harmonizimit të vlerësimit të brendshëm brenda vetë shkollave, e kur bëhet fjala për vlerësimin e jashtë ka një disproporcion edhe më të madh.

Vlerësimi brendshëm dhe i jashtëm mbetet ende sfidë për sistemin e arsimit, këtë e dëshmojnë statistikat dhe grafikonet e paraqitura, se nuk është arritur akoma një standard i dëshirueshëm te cilësia e vlerësimit.

### LËNDËT E PËRGJITHSHME

### Dita e parë:120 kërkesa (pyetje)




**Graf. 13. Paraqitja e rezultatit të arritur në lëndët e përgjithshme.**

### GJIMNAZI GJUHËSOR

### Dita e dytë: 80 kërkesa (pyetje)




**Graf. 14. Paraqitja e rezultatit të arritur në gjimnazin gjuhësor, dita e dytë.**



Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

## GJIMNAZI I PËRGJITHSHËM

**Dita e dytë: 80 kërkesa (pyetje)**




**Graf. 15. Paraqitja e rezultatit të arritur në gjimnazin e përgjithshëm, dita e dytë.**

## GJIMNAZI MATEMATIKOR

**Dita e dytë: 80 kërkesa (pyetje)**




**Graf. 16. Paraqitja e rezultatit të arritur në gjimnazin e matematikor, dita e dytë.**

## GJIMNAZI NATYROR

**Dita e dytë: 80 kërkesa (pyetje)**




**Graf. 17. Paraqitja e rezultatit të arritur në gjimnazin natyror, dita e dytë.**

## GJIMNAZI SHOQËROR

**Dita e dytë: 80 kërkesa (pyetje)**




**Graf. 18. Paraqitja e rezultatit të arritur në gjimnazin shoqëror, dita e dytë.**



Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

**ARSIMI PROFESIONAL-1**(Shëndetësi, Bujqësi, Hortikulturë, Teknologji ushqimore, kimi-teknologji, Gjeologji) **Dita e dytë 80 kërkesa**




**Graf. 19. Paraqitja e rezultatit të arritur në asimin profesional-I.**

**ARSIMI PROFESIONAL-II** (Tik, Komunikacion, Ndërtimtari, Arkitekturë, Gjeodezi, Tekstil, Xehtari)
**Dita e dytë: 80 kërkesa**




**Graf. 20. Paraqitja e rezultatit të arritur në asimin profesional-II.**

**ARSIMI PROFESIONAL-III (Administratë, Ekonomi, Hoteleri, Turizëm, Shërbimi postë-Telefoni) Dita e dytë: 80 kërkesa**




**Graf. 21. Paraqitja e rezultatit të arritur në asimin profesional-III.**

**ARSIMI PROFESIONAL-V (Art dhe Grafikë) Dita e dytë**




**Graf. 22. Paraqitja e rezultatit të arritur në arsimin profesional-V.**



Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

## Orët e planifikuar për nivelin e tretë të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2014/15:

-gjithsej **365794** orë,
-të realizuara **354026** orë,
-të parealizuara **11768** orë
Orë e planifikuara për këtë vit shkollor janë realizuar **96.78** – përqind, që krahasuar me vitin paraprak, ka një rënie për **1.07** – përqind.




**Graf. 23. Paraqitja e realizimit të orëve të planifikuara, të realizuara dhe të pambajtura (X-XII).**

## Vijueshmëria e nxënësve:

Gjatë vitit shkollor 2014/15, në nivelin e mesëm të lartë janë regjistruar gjithsej **625868**, **60.74** mungesa për nxënës, prej tyre të arsyeshme:- **327658**, **31.79** mungesa për nxënës, të paarsyeshme:- **279647**, **27.13** mungesa për nxënës.
Numri i nxënësve për këtë nivel të arsimit gjatë vitit shkollor 2014/15:
-**10313** nxënës, prej tyre **M-5258**, ose **50.98**-përqind dhe **F-5055** ose **49.01**-përqind.




**Graf. 24. Paraqitja e mungesave të nivelit (X-XII).**



Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

## Tabelat e përgjithshme të suksesit:

Në vijim do t'i prezantojmë tabelat e suksesit të fundvitit shkollor 2014-15, për rezultatet e nxënësve të arritura në të tri nivelet e arsimit parauniversitar dhe krahasueshmëria në mes vlerësimit të brendshëm me atë të jashtëm:

## Niveli i arsimi fillor (I - V)

| | | | | | | Kaluan klasën me sukses | | | | | | | | Përcillen | | | | Gjithsej orë gjatë vitit | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Shkolla | Nr. paraleleve | Numri I nxënësve | | | Shkëlqyeshëm | | Sh. mirë | | Mirë | | Mjaftueshëm | | Me nota negative | | Të pa notuar | | Të planifikuara | Të mbajtura | Nota mesatare |
| | | | M | F | GJ | Nr | % | Nr | % | Nr | % | Nr | % | Nr | % | Nr | % | | | |
| 1 | "Asim Vokshi" | 14 | 169 | 167 | 336 | 232 | 69.05 | 62 | 18.45 | 33 | 9.82 | 9 | 2.68 | | 0.00 | | 0.00 | 25740 | 25420 | 4.53 |
| 2 | "Dardania" | 31 | 474 | 472 | 946 | 816 | 86.26 | 90 | 9.51 | 37 | 3.91 | 3 | 0.32 | | 0.00 | | 0.00 | 25974 | 25701 | 4.81 |
| 3 | "Elena Gjika" | 31 | 476 | 428 | 904 | 804 | 88.94 | 67 | 7.41 | 24 | 2.65 | 3 | 0.33 | 0 | 0.00 | 6 | 0.66 | 25863 | 25595 | 4.78 |
| 4 | "Emin Duraku" | 17 | 199 | 162 | 361 | 285 | 78.95 | 32 | 8.86 | 16 | 4.43 | 5 | 1.39 | | 0.00 | 23 | 6.37 | 77577 | 76716 | 4.73 |
| 5 | "Faik Konica" | 26 | 372 | 342 | 714 | 620 | 86.83 | 69 | 9.66 | 23 | 3.22 | 2 | 0.28 | | 0.00 | | 0.00 | 21270 | 21029 | 4.79 |
